

SERCADIS

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



SERCADIS është fungicid sistemik me veprim preventiv dhe kurativ, efektiv në kontrollin e kromave (*Venturia inaequalis*, *V. pirina*) dhe hireve në pemë frutore farore, (mollë, dardhë, etj.). Fluxapyroxad bën pjesë në grupin e fungicideve të njohur si frenuesit succinate dehidrogjenazës (SDHI). Mënyra e veprimit në nivel molekular është, pengimi i enzimë succinate dehidrogjenazës, e njohur gjithashtu si Kompleksi II në zinxhirin e transportit elektroneve mitokondriale. Duke penguar prodhimin e energjise dhe per pasoje pengohet zhvillimi i kerpudhes deri ne shkatërrimin e plote te saj.

Lënda vepruese: *Fluxapyroxad 300 g/lit.*

Formulimi: *Suspension i koncentruar (SC)*

Deklaratat e rrezikut

H351: Dyshohet se mund të shkaktojë kancer.

EUH401: Te evitohen rreziqet e shendetit të njeriut dhe ambientit, në përputhshmëri me instruksionet për përdorim.

Deklarata parandaluese (Parandalimi)

P202: Në rast helmimi, tregojeni mjekut etiketën e produktit.

P280: Veshni doreza dhe veshje mbrojtëse për trupin.

Deklarata parandaluese (Reagimi)

P308+P311: Nëse je ekspozuar dhe nëse nuk ndjeheni mirë. Merrni keshillat ose kujdes mjekësor.

P391: Mblidhni dhe pastroni rrjedhjet.

Deklarata parandaluese (Ruajtja)

P405: Mbajeni të kyçur.

Deklarata parandaluese (Shkatërrimi)

P501: Shkatërrimi i permbajtjes /shisheve ne perputhje me rregullat në fuqi.

Përdorimi:

SERCADIS është një fungicid i cili përdoret për mbrojtjen e pemëve frutore farore gjatë gjithë sezonit vegjetativ, mollë dhe dardhë kunder kromës (*Venturia inaequalis*, *V. pirina*) dhe hirit (*Podosphaera leucotricha*). Në bimë të tjera e mbron nga kalbëzimi gri, antraknoza, alternaria.

Në mollë e dardhë: Për kontrollin e kromës përdoret me 0.25-0.3 lit preparat/ha, te tretur ne 450-1000 lit uje, me interval kohor 7-10 ditë.

Për kontrollin e hirit përdoret me 0.25-0.3 lit preparat/ha, te tretur ne 450-1000 lit uje, me interval kohor 7-14 ditë.

Në Vreshta: Për kontrollin e hirit përdoret me 0.15-0.2 lit preparat/ha, te tretur ne 450-1000 lit uje, me interval kohor 7-14 ditë.

Vërejtje për përdorimin:

SERCADIS perputhet kimikisht dhe fizikisht me një numër të madh produktesh te mbrojtjes së bimëve (Fungicide, Insekticide) dhe me formulime të ndryshme (EC, SC, SP, WG). Gjatë përzierjes me PMB e tjera, solucioni duhet të mbahet gjithmonë në gjendje të trazuar.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret ne kulturat e mesiperme dhe sipas dozave te rekomanduara.

Karenca:

Ne molle the fruta te tjera 35 ditë.

Ndikimi ne ekosistem:

H400: Shumë toksik për gjallesat ujore.

H410: Shumë toksik për jetën ujore duke shkaktuar efekte afatgjata të dëmshme.

Ky material dhe ambalazhet duhet të eliminohen në mënyrë të sigurtë.

Mos ndotni ujërat me produktin ose ambalazhet e tij. Mos pastroni pajisjet spërkatëse pranë ujërave sipërfaqësorë. Evitoni ndotjen nëpërmjet rrjedhjes. Pastrojeni ambalazhin me shpëlarje të trefishte. Për pastrim mbusheni ambalazhin me ujë në 1/3 e sasisë dhe tundeni për 1-2min, këtë përsëriteni dhe dy herë të tjera.

Magazini:

Ruajeni në ambalazhin origjinal, në vende të thata të ajrosura e të pa ekspozuara nga drita direkte e diellit.

Ruajeni nga temperatura ulët -10° C dhe nga temperaturat mbi 40° C.

Nr dhe data e regjistrimit: 648, datë 15.12.2016.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 1 lit.

Bar kodi perkates:

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit baze: Material i pa pershkueshem nga lageshtia.

Emri dhe adresa e Aplikantit: BASF SE. **Adresa:** Aktiengesellschaft, Ludwigshafen. Gjermani.

Emri dhe adresa e fabrikuesit: BASF SE. **Adresa:** Aktiengesellschaft, Ludwigshafen. Gjermani.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet në Republikën e Shqipërisë):



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
SHËRBIMEVE BUJQËSORE**

NrProt.

Tiranë, më ____ . ____ . 2016

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Nr. 648, datë 15.12.2016.

Bazuar në:

- Ligjin nr. 105/2016, “Për Mbrojtjen e Bimëve” (FZ Nr. 217, date 14.10.2016);
 - pikën 1, të kreut V, të Vendimit nr.1555, datë 12.11.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve”, i ndryshuar;
- Komisioni Shtetëror i Regjistrimit të PMB-ve,

VENDOSI:

Të bëjë **regjistrimin** për shitjen dhe përdorimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të **Fungicidit:**

SERCADIS

me të dhënat e mëposhtëme (si dhe gjithë specifikimet e bëra në dosjen e regjistrimit):

- 1. Aplikanti:** BASF SE. **Adresa:** Aktiengesellschaft, Ludwigshafen. Gjermani.
- 2. Prodhuesi:** BASF SE. **Adresa:** Aktiengesellschaft, Ludwigshafen. Gjermani.
- 3. Të dhënat teknike të PMB-së:**
 - a. Lënda vepruese:** *Fluxapyroxad 300 g/lit.*
 - b. Formulimi:** *Suspension i koncentruar (SC).*
 - c. Pamja:** *Lëng me ngjyrë të bardhë në rozë e lehtë.*
 - d. Përdorimi:** *Sipas etiketës bashkëngjitur.*

Kjo çertifikatë është e vlefshme deri më: **31.12.2022.**

DREJTORI

Flamur LAZE

Konceptoi: Ismet Biçi
Date: 21.12.2016
Pergj. Sekt. Kristaq Nica